



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:251393
Datë: 29.11.2023
Numri i dokumentit: 04982650

AA.nr.845/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS– Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Lirie Bunjaku - Zhitia, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditësit, Shoqata e Prokurorëve të Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson D. J. me autorizim, anëtar i Shoqatës Prokurorëve të Kosovës, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës, për shkak të anulimit të aktvendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të ushtuar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2767/2022, i datës 13.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.11.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Prishtinë, e datës 30.10.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2767/2022, i datës 13.10.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me Aktgjykimin e ankimuar në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses, Shoqata e Prokurorëve të Kosovës, me seli në Prishtinë, si e bazuar, në pikën II. Anullohet vendimi i të paditurës, Qeveria e Republikës së Kosovës i datës ..., me numër të referencës Nr...., si i kundërligjshëm, në pikën III. Mbetet në fuqi vendimi i datës ..., me numër ..., e nxjerr nga Qeveria e Republikës së Kosovës si dhe në pikën IV. Ky aktgjykim zëvendëson aktin administrativ të anuluar dhe ka karakter detyrues për palët.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, përmes përfaqësueses Avokaturës Shtetërore, ka ushtruar ankesë me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të: aplikimit të gabuar apo jo të drejtë të dispozitave ligjore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike,

me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e të paditurës, si të bazuar, prishë Aktgjykimin A.nr.2767/2022, e dt. 13.10.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, si dhe të refuzon kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar dhe e lë në fuqi vendimin nr....., e dt. ... të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e ankimuar pretendimet në ankesë pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 të LPK-së, i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjen se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e datës ..., me numër ..., e nxjerr Qeveria e Republikës së Kosovës është shfuqizuar vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër nr.... i datës ...; 2. Pagat për pozitat e përcaktuara me vendimin e shfuqizuar nga pika 1, kthehen në lartësinë e përcaktuar me rregullimin juridik të mëparshëm; 3. Ky vendim nuk ka efekt në uljen e pagave aktuale në sistemin e drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese në pajtim me nenin 15 të Ligjit Nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; nenin 35, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat nenin 21 paragrafi 1, nën – paragrafët 1.1 deri në 1.10 të Ligjit Nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit; nenin 18, paragrafi 1, të Ligjit Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenin 18, paragrafi 1, të Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial; 4. Ky vendim vlen deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese në lidhje me rastin KO... për vlerësimin e kushtetutshmërisë të Ligjit Nr.06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik”.

Ndërkaq, me vendimin kontestues të paditurës të datës ..., me numër referencës ..., ka shfuqizuar pikën 3 dhe 4 të vendimit nr. ... datë ..., të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkak të rrethanave të ndryshuara ligjore; pagat e sistemit gjyqësor, përfshirë ato të Gjykatës Kushtetuese i kthen në lartësinë e përcaktuar me rregullimin juridikë të mëparshëm; të gjitha pikët tjera të vendimit nr. ... mbesin të pandryshuar dhe ky vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Paditësi, i pa kënaqur me vendimin e lartcekur, ushtron padi në gjykatë duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit. Gjykata e shkallës së parë për këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesorë me dt.13.10.2023, në prani të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës bien aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe e anulon vendimin e të paditurës, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: Nga vendimi i kontestuar del se përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimet e goditura me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 48 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara,

ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Nga kjo gjendje e fakteve, Gjykata ka vlerësuar se vendimi i të paditurës është i kundërligjshëm, ngase me vendimin e datës ..., me numër ..., e nxjerr Qeveria e Republikës së Kosovës ka shfuqizuar vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.... të datës ..., ku në pikën 3 të vendimit thuhet se, “ky vendim nuk ka efekt në uljen e pagave aktuale në sistemin e drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese në pajtim me nenin 15 të Ligjit Nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; nenin 35, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat; nenin 2, paragrafi 1, nën – paragrafët 1.1 deri në 1.10 të Ligjit Nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit; nenin 18, paragrafi 1, të Ligjit Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenin 18, paragrafi 1, të Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial”, ku nga kjo edhe vet e paditura e ka konfirmuar se nuk mund të ulen pagat e prokurorëve dhe gjyqtarëve në sistemin e drejtësisë për shkak të garancioneve kushtetuese dhe ligjore, respektivisht deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese në lidhje me rastin KO... për vlerësimin e kushtetutshmërisë të Ligjit Nr.06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik.

Gjykata për të vlerësuar ligjshmërinë e aktit kontestues të paditurës i është referuar Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, respektivisht nenit 21 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 i cili përcakton se, “pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e ligjit, paga e prokurorëve të shtetit nuk do të zvogëlohet gjatë periudhës së shërbimit të tyre përpos nëse kjo caktohet si sanksion nga Këshilli Prokurorial apo Komisioni Disiplinor i Këshillit bazuar në përcaktimin se prokurori i shtetit ka kryer sjellje të pahijshme apo ndonjë vepër penale”. Ndërkaq neni 35 paragrafi 2 i Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat përcakton se, “paga e një gjyqtari nuk do të zvogëlohet gjatë mandatit në të cilin gjyqtari është emëruar, përveç sanksionimit disiplinor të vendosur nën autoritetin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës”. Bazuar në këto dispozita ligjore të lartcekura gjykata vlerëson se, pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve në sistemin e drejtësisë nuk mund të ulen gjatë mandatit të tyre pasi që janë të drejta të fituara dhe të garantuara me ligj dhe si të tilla nuk mund të cenohen.

Gjykata e shkallës së parë, po ashtu i është referuar edhe Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese refAGJ1584 /2020, në lidhje me rastin KO..., ku theksohet se, “Pavarësia e gjyqësorit, si njëra nga degët e pushtetit shtetëror, nënkupton që gjyqësori është i lirë nga presioni i jashtëm, dhe nuk i nënshtrohet ndikimit apo manipulimit politik, posaçërisht nga dega ekzekutive - ky kriter konsiderohet të jetë pjesë përbërëse e parimit themelor demokratik për ndarjen e pushteteve; (ii) burimet e mjaftueshme janë esenciale për të garantuar pavarësinë gjyqësore nga institucionet e tjera shtetërore dhe nga palët private - ashtu që gjyqësori të mund të kryej detyrat e tij me integritet dhe efektivitet, duke u kujdesur kështu për besimin e publikut në drejtësi dhe sundim të ligjit; (iii) zvogëlimi i buxhetit nga pushteti ekzekutiv është një shembull se si burimet e gjyqësorit mund të vihen në presion të tepruar dhe të padëshiruar; (iv) koncepti i pavarësisë prezumon, në veçanti, që organi në fjalë ushtron funksionet e tij gjyqësore krejtësisht në mënyrë autonome, pa iu nënshtuar ndonjë kufizimi hierarkik apo në vartësi të ndonjë organi tjetër dhe pa pranuar urdhra apo instruksione nga çfarëdo burimi; (v) shpërblimi i gjyqtarëve duhet të garantohet me ligj dhe të jetë në përpjesëtim me dinjitetin e profesionit të tyre dhe barrën e përgjegjësisë dhe se paga e gjyqtarit nuk mund të ulet përgjatë mandatit (përveç situatave të jashtëzakonshme të vështirësive ekonomike)”. Gjithashtu edhe Ligji nr.08/L-193 mbi Ndarjen Buxhetore për Buxhetin Republikës së Kosovës për vitin 2023, i cili parashikon që “për vitin 2023 rritja ekonomike të ngadalësohet në 2.6%. Deficiti buxhetor për vitin 2023 parashikohet të ulet në nivelin 2.6% të PBB nga 3.3% të PBB që pritët deri në fund të vitit 2022”.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në të lartcekurat, gjeti se vendimi kontestues i të paditurës nuk është nxjerr mbi bazën e ndonjë situatë të jashtëzakonshme ose vështirësi financiare, pasi edhe vet buxheti për vitin 2023, parashikon rritje ekonomike në vlerën prej 2.6%, e që nga kjo konsiderohet se e paditura ka vepruar në mënyrë jo të drejt, pasi shteti nuk ka ndonjë krizë financiare të jashtëzakonshme ekonomike. Me tej, paga e prokurove dhe gjyqtarëve garantohen me ligj dhe duhet të jetë në përpjesëtim me dinjitetin e profesionit të tyre dhe barrën e përgjegjësisë dhe se paga e tyre nuk mund të ulet përgjatë mandatit të tyre përveç situatave të jashtëzakonshme të vështirësive ekonomike, ashtu siç është vlerësuar nga Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të lartcekur. Gjykata e shkallës së parë, i është referuar edhe Konventës Evropiane Për të Drejtat e Njeriut - nenit 1 i cili thekson se, “Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”. Ndërsa, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut - neni 23 i cili thekson se, “Gjithkush ka të drejtën për punë, të zgjedhë lirisht profesionin, të ketë kushte të favorshme punë dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia. 2. Gjithkush pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të njëjtë të marrë rrogë të njëjtë. 3. Gjithkush që punon ka të drejtën për një shpërblim të drejtë dhe të favorshëm, në mënyrë që ti sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor dhe, në qoftë se do të jetë e nevojshme ky shpërblim të plotësohet edhe me mjete të tjera të sigurimit shoqëror”. Për me tej, gjykata e shkallës së parë, duke shkuar edhe më tej aktgjykimin e sajë e ka bazuar edhe në praktikën gjyqësore të vendeve të ndryshme evropiane si, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë me numër të referencës SLO -2009-3-006 - kjo gjykatë kishte arsyetuar se, “Mbrojtja nga ulja e pagës së gjyqtarit individual, si e tillë ka për qëllim të sigurojë stabilitetin e saj dhe rrjedhimisht pavarësinë e gjyqtarit, duhet të kuptohet si mbrojtje ndaj çdo ndërhyrje që mund të shkaktojë ulje të pagës së gjyqtarit, të cilin gjyqtari e pret në mënyrë të arsyeshme me marrjen e detyrës. Kështu që jo vetëm pagat themelore të gjyqtarëve janë ato që mbrohen nga ulja, por edhe të gjitha pagesat për të cilat gjyqtarët kanë të drejtë për shkak të kryerjes së detyrës gjyqësore. Prandaj, Gjykata kushtetuese e Sllovenisë kishte gjetur shkelje duke konstatuar që rregullimi ligjor i kontestuar ishte në kundërshtim me nenin 2 të Kushtetutës Sllovene”. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Qipros në rastin me numër të referencës CYP2014-2-001- kjo gjykatë kishte arsyetuar se, “kjo nevojë nuk është më e rëndësishme sesa nevoja për të mbrojtur pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit, që është qëllimi i qartë i dispozitave të Nenit 158.3 të Kushtetutës, dhe një çështje me rëndësi të madhe për sa i përket interesit publik. [...] Prandaj, ai [Ligji i kontestuar] arrin në një ulje të palejueshme, të pafavorshme të kompensimit të gjyqtarëve (pagës), dhe në kundërshtim me dispozitat e qarta të Nenit 158.3 të Kushtetutës”. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, respektivisht, neni 102 përcakton se, “Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat; 2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata; 3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit; 4. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm”. Ndërsa, neni 109 pika 2 përcakton se, “Prokurori i Shtetit është institucion i paanshëm, dhe vepron në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit”. Prandaj, Gjykata e shkallës së parë si përfundim, në frymën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dispozitave ligjore të lartcekura, Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, instrumenteve ndërkombëtare dhe praktikave gjyqësore të vendeve të ndryshme evropiane erdhi në përfundim se, vendimi kontestues i të paditurës nuk është i bazuar në ligj, andaj gjykata, kërkesëpadinë e paditëses e aprovoi si të bazuar duke anuluar vendimin e të paditurës, Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës ..., me numër të referencës Nr...., si të kundërligjshëm dhe duke lënë në fuqi vendimin i datës ... me numër ... , të nxjerr nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ashtu si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor konkludimin e tillë juridik të gjykatës së shkallës së parë andaj kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, ka vendosur drejtë dhe drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore dhe procedurale me anulimin e vendimit të atakuar me padi, sepse i njëjti nuk është i plotë dhe përmbajtjesor për tu vlerësuar ligjshmëria e tij si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, sepse është i përfshirë me të meta esenciale. Organi i paditur është dashtë që duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të nxjerr vendim përmbajtjesor ashtu siç parashihet me nenet 47, 48, të LPPA-së, i cili do të duhej ti kishte në përmbajtjen e tij përmbledhjen faktike të çështjes, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ deklarimin e bazës ligjore në të cilat bazohet akti. Arsyetimi të jetë i qartë dhe i argumentuar lidhur me mënyrën e vendosjes ashtu si parashihet në nenin 48 të LPPA, kur me akt, kufizohen mohohen, shuhen apo preken interesat ligjore ose, vendosen detyrime apo ndëshkime. Nga këto fakte rezulton se i padituri me mënyrën e vendosjes ka nxjerrë vendim jo të drejtë dhe jo ligjor ashtu si parashihet me dispozitat e cekura të LPPA-së. Andaj, kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vendosur kur e anulon vendimin e organit administrativ si në vështrim të nenit 43.3, 46.2 të LKA, dhe paditësit i aprovon në tërësi kërkesëpadinë si të bazuar dhe e lë në fuqi vendimin e datës 12.02.2020, me numër 01/02, të nxjerr nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Kolegji po ashtu vlerëson se të gjeturat e Gjykatës së shkallës së parë, janë të drejta dhe të bazuara kur vendimin e saj e mbështet në faktet dhe provat siç janë vendimi i datës ..., me nr...; vendimi i datës ... me numër të referencës ...; vendimi i datës ... me numër të referencës KPK/Nr..., e protokolluar me datën ... me numër të protokollit ...; aktgjykimi me numër të referencës AGJ.1584/20, për rastin nr.KO219/19 i datës 09.07.2020, ku nga këto prova vërtetohet se vendimi kontestues është në kundërshtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese refAGJ1584 /2020, në lidhje me rastin KO..., ku theksohet se, “Pavarësia e gjyqësorit, si njëra nga degët e pushtetit shtetëror, nënkupton që gjyqësori është i lirë nga presioni i jashtëm, dhe nuk i nënshtrohet ndikimit apo manipulimit politik, posaçërisht nga dega ekzekutive - ky kriter konsiderohet të jetë pjesë përbërëse e parimit themelor demokratik për ndarjen e pushteteve; (ii) burimet e mjaftueshme janë esenciale për të garantuar pavarësinë gjyqësore nga institucionet e tjera shtetërore dhe nga palët private - ashtu që gjyqësori të mund të kryej detyrat e tij me integritet dhe efektivitet, duke u kujdesur kështu për besimin e publikut në drejtësi dhe sundim të ligjit; (iii) zvogëlimi i buxhetit nga pushteti ekzekutiv është një shembull se si burimet e gjyqësorit mund të vihen në presion të tepruar dhe të padëshiruar; (iv) koncepti i pavarësisë prezumon, në veçanti, që organi në fjalë ushtron funksionet e tij gjyqësore krejtësisht në mënyrë autonome, pa iu nënshtuar ndonjë kufizimi hierarkik apo në vartësi të ndonjë organi tjetër dhe pa pranuar urdhra apo instruksione nga çfarëdo burimi; (v) shpërblimi i gjyqtarëve duhet të garantohet me ligj dhe të jetë në përpjesëtim me dinjitetin e profesionit të tyre dhe barrën e përgjegjësisë dhe se paga e gjyqtarit nuk mund të ulet përgjatë mandatit (përveç situatave të jashtëzakonshme të vështirësive ekonomike)”, po ashtu vendimi kontestues i të paditurës nuk është nxjerr mbi bazën e ndonjë situatave të jashtëzakonshme ose vështirësi financiare, pasi edhe vet buxheti për vitin 2023, parashikon rritje ekonomike në vlerën prej 2.6%, e që nga kjo konsiderohet se e paditura ka vepruar në mënyrë jo të drejt, pasi shteti nuk ka ndonjë krizë financiare të jashtëzakonshme ekonomike. Me tej, paga e prokurove dhe gjyqtarëve garantohen me ligj dhe duhet të jetë në përpjesëtim me dinjitetin e profesionit të tyre dhe barrën e përgjegjësisë dhe se paga e tyre nuk mund të ulet përgjatë mandatit të tyre përveç situatave të jashtëzakonshme të vështirësive ekonomike, ashtu siç është vlerësuar nga Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të lartcekur.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit të ankimuar nuk i ka vlerësuar drejtë provat

e paraqitura nga ana e të paditurës, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Kolegji vlerëson se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore. Sepse, nuk është kontestuese se vendimi i organit të paditur nuk është përmbajtjesor ashtu si parashihet me dispozitat e cituara si më lartë të LPPA-së. Kurse, sa i përket pretendimeve tjera ankimore se gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, sepse nuk e ka marrë parasysh se pagat e gjyqtareve dhe prokurorëve janë rritur me vendim të qeverisë dhe jo me ligj si dhe pretendimin se vendimi i Qeverisë nr. ... i datës ..., me të cilin janë rritur pagat e këtij sektori është pa arsytim dhe i kundërligjshëm. Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi sepse vlerësoi se janë të paqëndrueshme, të paargumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit në asnjë dispozitë ligjore nuk përcaktohet se në cilën formë duhet të ngritën pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, mirëpo përcaktohet me ligj se të njëjtat pavarësisht arsyes së rritje nuk mund të zvogëlohen, ashtu siç edhe është arsyetuar në aktgjykimin e ankimuar, ndërsa sa i përket vendimit nr.... i datës ..., me të cilin janë ngritur pagat, i njëjti vendim nuk mund të kundërshtohet e as të ankimohet nga shkak se i njëjti është vendim përfundimtar në procedurë administrative i njëjti është ekzekutuara dhe i njëjti vendim asnjëherë nuk ka qenë e as nuk është objekt shqyrtimi në këtë procedurë gjyqësore, andaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë nuk është marrë me pretendimin e të paditurës lidhur me këtë çështje. Aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kolegji i kësaj gjykate.

Andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të një pas njëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në vështrim të nenit 200 të LPK-së, i zbatueshëm si në vështrim të nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË
AA.nr.845/23, me datë 20.11.2023

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi